

VENDIM
Nr. 66, datë 17.11.2015

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetari	Gjykatës	Kushtetuese
Vladimir Kristo	anëtar	“	“
Sokol Berberi	anëtar	“	“
Vitore Tusha	anëtare e	“	“
Altina Xhoxhaj	anëtare e	“	“
Gani Dizdari	anëtar	“	“
Besnik Imeraj	anëtar	“	“
Fatos Lulo	anëtar	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar	“	“

me sekretare Edmira Babaj, në datën 30.6.2015 mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen nr. 33 Akti, që i përket:

KËRKUES: Durim Sulkja

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Enti Kombëtar i Banesave, Drejtoria Rajonale Elbasan, Zyra Përmbartimore “Çërraga”

OBJEKTI: Interpretim dhe plotësim i vendimit nr. 15, datë 30.3.2015 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 28, 29 dhe 80 pika 2 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Fatmir Hoxha, shqyrtoi dokumentet e paraqitura dhe bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kërkuesi Durim Sulkja në datën 6.6.2014 i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese duke pretenduar se nuk i është lidhur kontrata e shitjes së banesës në zbatim të vendimit gjyqësor të formës së prerë. Ai ka pretenduar se nuk ka mundur të lidhë kontratën e shitblerjes dhe se i është drejtuar disa herë Drejtorisë Rajonale të Entit të Banesave (DREB-së) dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Entit Kombëtar të Banesave (DPEKB-së) për lidhjen e saj. Për këtë arsye, kërkuesi ka pretenduar se i është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor si pasojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë nr. 10-2012-1538 (762) datë 23.10.2012 të Gjykatës së Apelit Durrës.

2. Gjykata Kushtetuese, me vendimin nr. 15, datë 30.3.2015, ka vendosur njëzëri rrëzimin e kërkesës.

3. Pas shpalljes së vendimit, kërkuesi në datën 10.4.2015 i është drejtuar me kërkesë Gjykatës Kushtetuese duke kërkuar interpretimin dhe plotësimin e vendimit nr. 15, datë 30.3.2015 të kësaj gjykate.

II

4. **Kërkuesi Durim Sulkja** ka kërkuar interpretimin dhe plotësimin e vendimit nr. 15, datë 30.3.2015 të Gjykatës Kushtetuese si vijon:

4.1 Në paragrafin nr. 29 për fjalinë: “Gjykata vlerëson se është kërkuesi që është bërë pengesë për realizimin e procesit të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë. Ai ka ngritur disa herë pretendime të paarsyeshme”.

4.2 Në paragrafin nr. 34 për fjalinë: “Gjykata vlerëson se sjellja e autoriteteve, përfshirë edhe atë të subjektit të interesuar, nuk ka qenë shkak për mosekzekutimin e vendimit gjyqësor”.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkesës

5. Gjykata Kushtetuese (Gjykata) ka theksuar se për të ushtruar kompetencën e parashikuar në nenin 80, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë” për interpretimin, plotësimin ose ndreqjen e gabimeve në vendimin saj, ajo mund të vihet në lëvizje vetëm nga palët pjesëmarrëse në gjykimin e çështjes (*shih vendimet nr. 166, datë 20.6.2007; nr. 23, datë 23.4.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

6. Gjykata vëren se kërkuesi Durim Sulkja legjitimohet *ratione personae* për paraqitjen e kësaj kërkesë dhe *ratione temporis*, pasi kërkesa drejtuar Gjykatës Kushtetuese është paraqitur në datën 10.4.2015, brenda afatit 2-mujor nga shpallja e vendimit, parashikuar nga neni 80, pika 1, i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

B. Për themelin e pretendimit

7. Kërkuesi ka pretenduar interpretimin dhe plotësimin e vendimit nr. 15, datë 30.3.2015 të Gjykatës Kushtetuese. Ai ka parashtruar se pretendimet e tij nuk mund të konsiderohen të paarsyeshme, pasi ato kanë qenë të lidhura me procesin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë dhe me faktin se nga subjekti i interesuar janë përdorur dy standarde kontratash. Nga cenimi i së drejtës së ekzekutimit të vendimit gjyqësor i është cenuar e drejta e pronësisë dhe e drejta për të lidhur kontratën e shitblerjes me pagesë të menjëhershme. Sipas kërkesës, subjekti i interesuar nuk ka zbatuar një vendim gjyqësor të formës së prerë dhe nuk ka shfaqur vullnetin për të qenë i pranishëm pranë noterit për të nënshkruar kontratën e shitblerjes.

8. Gjykata, bazuar në nenin 80/1 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, ka të drejtë ta interpretojë vendimin e saj në rast dyshimi ose mosmarrëveshjeje për kuptimin e tij, por pa ndryshuar përmbajtjen e këtij vendimi. Gjykata nuk mund të anulojë ose të ndryshojë vendimin e saj.

9. Gjykata konstaton se nga shqyrtimi i pretendimeve të paraqitura në kërkesën për interpretim dhe plotësim të vendimit nuk ka rast dyshimi ose mosmarrëveshjeje për kuptimin e paragrafëve të vendimit, si dhe nuk ka ndonjë gabim apo pasaktësi në shkrim. Pretendimet e kërkesës janë të lidhura me zgjidhjen e çështjes në themel dhe janë të njëjta me pretendimet e paraqitura me kërkesën e mëparshme, të cilat Gjykata Kushtetuese i ka shqyrtuar dhe i ka arsytuar me vendimin nr. 15, datë 30.3.2015.

10. Gjykata çmon se paragrafët e vendimit, për të cilat kërkuesi ka pretenduar interpretimin dhe plotësimin, janë konkluzione të qarta të qëndrimit të mbajtur nga kjo gjykatë, e si të tilla nuk mund të ndryshohen apo të anulohen.

11. Për rrjedhojë, Gjykata arrin në përfundimin se kërkesa e kërkesës Durim Sulkja për interpretimin dhe plotësimin e vendimit nr. 15, datë 30.3.2015 të Gjykatës Kushtetuese është haptazi e pabazuar dhe si e tillë duhet rrëzuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 80 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Sokol Berberi, Vladimir Kristo, Gani Dizdari, Altina Xhoxhaj, Vitore Tusha, Fatmir Hoxha, Fatos Lulo, Besnik Imeraj